

SHENJTËRORJA “ZOJA E SHKODRËS” NË PËRBALLJE ME RREBESHET HISTORIKE (shek. XV-XX)

Hyrje

Të jesh me fat apo pa fat nuk është as merita e as faji yt, apo i të tjerëve, për arsye të kushteve dhe situatës, për shkak të pozitës apo gjendjes gjeografike, politike etj. Shtrohet pyetja: çfarë mund të thuhet për figurën murale, “Zoja e Shkodërs Drita e Shqypniis”, e zhvendosur nga kisha bri kalasë së Shkodrës për në Gjenacano, në vitin 1467, e cila pas pak viteve u shpall figurë mrekullibërëse nga Papa Pali II, (1464-1471), duke u bërë që në këtë kohë ngjarje me përmasa botërore?

Kjo histori e figurës së Zojës së Bekuar, domosdo na kthen në lashtësinë e Arbërisë, e në veçanti në qytetin e Shkodrës, e cila së bashku me Dioklenë, qytete të vjetra ilire, luanin një rol shumë të rëndësishëm në fushën gjeopolitike të zhvillimit kulturor e pagëzimor në kohën romake. Me pushtimet sllave e avare në shek.VI, megjithëse shënohen degradime të këtij zhvillimi, me pranimin e krishterimit nga serbët në shek. IX-XI, evidentohen ndryshime pozitive në këtë pellg dhe ura ndërtimi të përbashkëta, të cilat kulmojnë sidomos në shek. XIII me ndërtimin e shumë objekteve kishtarë.

Zona e Shkodrës post ilire ishte hapësira ku shtresoheshin strukturat e ndryshme të elementit romak, shqiptar, sllav, bizantin, kultura qytetare të Adriatikut katolik e atij bizantin ortodoks. Shkodra me potencialin e saj, si një e lidhjeve në mes lindjes dhe perëndimit, vazhdonte të ishte e rëndësishme edhe në kohën veneciane, në fushën e humanizmit, kulturës, pikëpamjeve filozofike e teologjike, shkencore e juridike, në anën ndërtimore e artistike dhe fusha të tjera. E gjithë kjo kuptohet nga dokumentet e kohës, kur flitet për qytetet e Arbërisë veneciane si: Kotori, Shkodra, Tivari, Ulqini, Shasi, Drishti, Lezha e Durrësi. Ky lulëzim perëndimor zgjati deri me daljen në skenën politike të pushtuesve osmanë, në trevat shqiptare, në fillim të shek. XIV-XV, kur situata filloi të marrë një kaheje tjetër politike.

Në kudër të këtij zhvillimi para osman duhet parë puna ndërtimore artistike më kulmore, e cila reflektohej në objekte fetare, si: kishat katedrale dhe kishat kanonike, abacitë dhe kuvendet e urdhrave kishtarë dhe shenjtërore të përmasave krahinore e më gjerë. Vetëm në shek. e XIII, në territorin e Arbërisë Venedikase shënohet se janë ndërtuar 30 kuvende dhe kisha rregulltarësh nga mbretëresha e Zetës, (He)lena azhuniane, e martuar me mbretin serb Stefan Uroshin. (1237-1272). Në këtë bum ndërtimesh, katër kishat e kuvendet françeskane, në Kotor, Tivar, Ulqin e Shkodër janë ndërtuar nga motra e Helenës, Maria Anselmus, e cila qe varrosur në kishën e Shën Mërisë në Ulqin, në vitin 1307.

Provë për ndërtimin e kishave dhe të kuvendeve në Shkodër është shënimi i priftit shkodran Marin Barleci, i cili në ditarin e tij të botuar në Venedik, në vitin 1504, duke folur për tmerrin e rrethimit të Shkodrës nga turqit, shprehet se brenda qytetit dhe përreth e qark, që më parë kanë funksionuar kishat: në kala kisha katedrale e “Shën Shtjefnit”, “Shën Markut”, “Shën Panteleonit” dhe e “Shën Vlashit”. Përtej Bune, në Kasem, kisha e “Maria Magdalenës”, “Shna Prenes”, e “Shën Nikollit”, e të “Shëjtes Krygjë”. Pos këtyre, Valentini rreshton përreth kalasë: kishën e “Shën Gjergjit”, “Shën Aponalit”, e “të gjithë Shëjtënve”, “të Shën Teodorit” etj... dhe në jug-perëndim të kalasë, bri murit, qëndronte kisha e “Shën Marisë”, e quajtur më vonë “Zoja e Këshillit të Mirë” si dhe në afërsi, kisha e “Shën Ilisë” dhe e “Shën Lazrit” që gjendeshin në pjesën e Berdicës dhe udhëhiqeshin nga dominikanet. Kishat e lartpërmendura të shek. XIII-XIV, i gjejmë edhe në “Regjistrin e Kadastrës dhe Koncesioneve për rrethin e

Shkodrës”, 1416-1417, të përgatitur nga Injac Zamputi, e që pas pushtimeve osmane në vitin 1479, u rrënuan apo shndërruan në xhami.

Disa nga Kishat mesjetare të Zojës së Bekuar në Arbëri

Përhapja e rregulltarëve në mesjetë në këtë zonë si: benediktinët, dominikanët, françeskanët, karmelitanët etj., tërhiqte me vete, pos të tjerave, nderimin e madh që kishin ndaj Nënës së Krishtit, të lumes Mari, e cila në krishterim ka një rol tejet të rëndësishëm, sikurse perëndesha Vesta kishte për pellazgët e më vonë për ilirët paganë. Me këtë synim duhen parë ndërtimet zinxhirë të manastireve kushtuar Zojës së Bekuar: të Shën Marisë, në Budva; Zojës së Bekuar, në Krajë; në shek. X dhe ajo e Dejës. Kurse në mesjetë kemi: kishën e Zojës jashtë mureve të kalasë në Tivar, Kishën katedrale në dioqezën e Ulqinit, kishën kanonike të Shasit, Kishën e qytetit të Krujës, atij të Drishtit dhe kuvendin e kishës së “*Zojë së Bekuar*”, për të cilën jemi duke folur, të ndërtuar jashtë mureve të kalasë, por brenda mureve të qytetit të Shkodrës, në shek. XIII.

Studiuesja Fatbardha Shkupi, duke cituar bizantologun e njohur Theofan Popa, shprehet se Abacia e Shirqit, e rindërtuar në vitin 1293, nuk ishte e stilit bizantin, por një faltore gotike e shek. XIII, sikurse edhe “Kisha e Zojës”, nën kala, e ndërtuar po në të njëjtin shekull, me të njëjtin stil dhe gurë të marrë nga kodra e kalasë së Shkodrës.

Për vendin se ku gjendej saktësisht në mesjetë “Kisha e Zojës së Bekuar”, e cila në dokumente figuron edhe si “Zoja Nunciatë” (Lajmërimi i Zojës), kemi informacione të ngjashme nga burime të ndryshme. Në dokumentin më të vjetër që kemi rreth toponimeve, “*Regjistri i Kadastrës dhe Koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417*”, duke përkthyer se ku gjendej në muret e qytetit shtëpia e Gajard Gajardit e ku mbahej kripa e bashkisë, thuhej se ajo kufizohej edhe me kishën e “Shën Marisë së Shkodrës”, bri kalasë. Po kështu përmendet “Kisha e Zojës”, duke e përkufizuar pasurinë e Aleka Benkos në këtë zonë. Pastaj, duke përkthyer se ku gjendej vreshta e Piero Boçinit, në “*Vreshtat e Shkodrës*”, në Berdicë, thuhej se nga pjesa e kalasë vreshta kufizohej me pasurinë e “Kishës së Zojës së Shkodrës”. Po kështu thuhej edhe kur flitej për vreshtin e Proganit, e cila kufizohej me pasurinë e kësaj kishe, e monumente të tjera.

Për vendndodhjen e këtij lokaliteti në mesjetë, shprehet edhe albanologu i shquar, Giuseppe Valentini, në shkrimin e tij botuar te revista “*Leka*”, (nr. 8, viti 1934), duke u shprehur se themelet e këtij objekti mesjetar duhet të jenë në patalokun e tanishëm, ku akoma sot shihen qartas gërmadhat e vjetra, apo sa pak e zgjeruar në afërsi të lumit Drin, në vendin e një Teqeje dhe të dervishëve, ku Teqeja, sipas gojëdhënës, është ndërtuar në vitin 1649, si një konkurrencë dhe pengesë për kishën “Zoja e Shkodrës” apo “Shën Marisë Tebuena”. Për disa themele të vjetra në afërsi të Drinit dhe një dysHEME rreth 4 x 3 metra me mozaik, flasin edhe gjurmimet arkeologjike të kryera nga Institutit i Kërkimeve Arkeologjike në Tiranë, në vitin 1978. Për vendndodhjen e Shenjtërores së Zojës sipas variantit të Valentinit, shprehet edhe historiani i parë shqiptar Dom Ndoc Nikaj, si kontribues i vyer i viteve të 1900-ës të Shenjtërores. Në kujtimet e tij ai shprehet se “*Kisha e Këshillit të Mirë*”, sipas traditës popullore, duhet të ketë qenë aty ku sot janë gërmadhat e tepricat e vjetra, apo për shkak të madhësisë së Shenjtërores, mund të ketë qenë shtrirë deri në shtratin e ujit të Drinit. Pohimi i ipeshkvit të Shkodrës, Gjergj Radovanit, më 27 maj të vitit 1780, dërguar Propagandës Fide në Romë, se Kisha, prej së cilës qe shkëputur afresku i Zojës së Këshillit të Mirë, është Kisha e “Shën Marisë Magdalenë” në vendin Kazenë përtej lumit Buna, nuk është pasqyruar nga relatorët të mëparshëm, si: fisniku, Ndoc Kol Kamsi, 1748, kapedani Shtjefen Medini, dhe as nga më të më vonshmit, si: Imzot Rafaele D’ Ambrosio, Don Engjell Radoja, padre Giampiero de Bergamo e don Pashko Junku, në relacionin e tyre më 8 korrik të vitit 1878, dërguar Selisë së Shenjtë. Prandaj ky pohim i Radovanit mbetet shumë i paqartë dhe i pa argumentuar mirë.

Zhvillimi i artit pamor në Dalmaci ka pasur jehonën e vet edhe në Arbërinë veriore Venedikase në shek. XIII. Nga relacionet e ipeshkvijve dërguar Selisë së Shenjtë, kuptojmë se kisha katedrale e “Shën Gjergjit” në Tivar ka qenë e stolisur me piktura të ndryshme murale madhështore. Po kështu dëshmohet edhe për kishat dhe kuvendet në dioqezën Shkodrës, si Kisha katedrale e “Shën Shtjefnit”, e pikturuar bukur dhe në fund të shek. XV e shndërruar në Xhami, kishat përreth kalasë që e patën të njëjtën fatkeqi rrënim, pastaj të Drishtit, Shasit Lezhës, etj. Në relacionin e tij të vitit 1610, Marin Bici shprehet se kisha e “Shirqit” ka qenë më e bukura e stolisur në tërë Shqipërinë. Po kështu flitet edhe për kishën e “Shna Prendës” në Obot dhe shumë të tjera. Zhvillimin e artit të suksesshëm në periudhën e mesjetës, në Arbëri, sot e dëshmojnë prania e pikturave, edhe pse të dëmtuara, në kishat: “Pllanë”, “Balldre”, “Rubik” e “Derven”.

Ndërtimi i kishave, abacive dhe kuvendeve në mesjetë, në tokën Arbërore kushtuar Zojës së Bekuar dhe stolisja me ikona të “Zojës së Bekuar”, ishte shenjë e nderimit të madh të popullit tonë ndaj kësaj Nënë Hyjnore. Kjo shihet edhe nga fakti se një ndër 7 pikturat e realizuara nga bashkëkohësi i saj, Shën Luka ungjilltar, kushtuar “Zojës së Bekuar”, ka qëndruar në katedralen e Ulqinit deri para shkatërrimeve osmane në vitin 1571. Në këtë vazhde të vlerësimit të posaçëm ndaj Nënës së Krishtit, është edhe kisha “Zoja e Këshillit të Mirë”, bri kalasë së Shkodrës, e shek. XIII, e shndërruar në një shenjtërore mbarëkombëtare, për shkak të mrekullive të ndodhura nga rrezatimi shpirtëror i ikonës murale, vendosur në altarin qendror të këtij tempulli fetar. Duke ruajtur një mister rreth vetes, që tejkalon fazën e krishterimit, Shenjtëroja e “Zojës së Këshillit të Mirë”, bëri që heroi ynë legjendar, Gjergj Kastrioti dhe Donika, të çonin dhurata të çmuara prej ari e argjendi e ta donin këtë shenjtërore mrekullibërëse, me një dashuri të përkushtuar e entuziaste. E “Nëna e Kujdesit të Mirë”, siç e quanin disa, si shpërblim, jo vetëm që e bëri atë një shëmbëlltyrë të përsosmërisë kishtare, por i dha edhe pushtet të pamposhtur, jo vetëm që shpëtoi Shqipërinë nga pushtimet e egra turke, por edhe krishterimin gjatë mbretërimit të tij.

Pushtimet osmane - kohë shkatërrimi dhe errësire

Arbëria ishte një prej rajoneve në konflikt, ku shtetet perëndimore kërkonin ta ndalnin shtrirjen e Perandorisë Osmane në Ballkan. Kjo gjë mund të bëhej vetëm nëpërmjet një angazhimi që nuk ishte i kufizuar në kohë. Për këtë arsye Venediku krijoi në një administrim të qëndrueshëm të qyteteve bregdetare në veri të Arbërisë. Në hapësirën e Arbërisë, Sinjoria nuk ndeshi me ndonjë shoqëri të prapambetur. Përkundrazi asaj i dilnin përballë komuna të mirë organizuara, një fisnikëri e pasur në provincë, bashkësi të mëdha fshatare, popullata luftarake gjysmë nomadë dhe dymbështues princash lokal.

Më kërcënime nga Perandoria Osmane për marrjen e pushtetit të disa qyteteve arbërore në vitin 1434, të cilat i mbante Venediku, për një kohë të gjatë Shqipëria u gjend në një shtettrëhim tmerrues dhe gjendje lufte. Si rezultat i këtij presioni, në Arbërinë Venedikase në këtë kohë pa paqe, ndodhen ndryshimet në mënyrë vendimtare në shumë fusha si: mënyra e jetesës, struktura e popullatës, zhvillimet demografike, ekonomike, politike etj.

Lufta në Arbëri deri në fushatat e Mehmetit të II-të i ngjante një zjarri të ngadaltë, i cili aty-këtu shpërthente në mënyrë të kufizuar. Zjarr bumbullues e gjithëpërfshirës, ai do të bëhej, vetëm kur makineria ushtarake osmane e mbuloi në mënyrë sistematike krejt rajonin me shkatërrime, depërtime dhe shuarje të çdo qëndrese të popullit.

Administratori venecian i Danjit, Marino Mauro, në relacionin e tij të vitit 1466-1467, dëshmon, se sulltan Mehmeti II, në vitin 1465 erdhi me një ushtri të hatashme në Arbëri dhe u orvat të merrte kështjellën e Krujës, por nuk arriti dot, por pushtoi krejt vendet e tjera rreth e rrotull të të gjitha kalave. Me 23 mars 1466, turqit iu vërsulen Danjit, e dogjën, e plaçkitën dhe e shkatërruan në një pjesë të mirë dhe pjesa më e madhe e banorëve e kishin braktisur vendin.

Në fakt qysh se u shfaqën për herë të parë në hapësirën arbëreshe, osmanët shkaktuan në mënyrë të përsëritur lëvizje masive arratie të popullatës vendase, e cila gjente strehë në radhë të parë në Durrës e Raguzë, për të kaluar prej andej për në Itali e Venedik. Sulmet ushtarake dhe hakmarrja turke e bënë popullin që të parashikonin jo vetëm humbjen e menjëhershme të pasurive, por edhe shtypjen, ndikimin brutal, shfarosjen e plotë të besimit dhe të qytetërimit. Duke mos parë asnjë rreze shprese nga këta njerëz, populli iu drejtua qiellit: mbushte tempujt e shenjtë, shumëfishonte lutjet publike, mbante kreshmë të rreptë dhe i lartësonte Hyjit premtime të çdo lloji, që ta ndalte fatkeqësinë e zemërimit të tij.

Ngjarja që ka lidhje me zhvendosjen e afreskut të “Zojës së Këshillit të Mirë” për në Gjenacano, ishte fushata e egër e ndërmarrë në Arbërinë e mesme dhe veriore nga sulltan Mehmeti II, në vitin 1466 -1467. Duke dëgjuar për sëmundjen e Gjergj Kastriotit, në fillim të vitit 1467, sulltan Murati do të shprehej se, kush do të më ndalojë t’i shfaros të krishterët? Kanë humbur shpatën dhe mburojën e tyre. Kërcënimet e sulltanit pasuan ngjarjet e pranverës të vitit 1467, si: rrethimi i dytë i Krujës, Lezhës, Drishtit, Shkodrës dhe pushtimi i Danjës. Me këto djegie, tortura e vrasje të shqiptarëve nga Mehmeti II, populli ynë ishte trullosur dhe u mendua së mbërriti dita e gjykimit e Hyjit, ku e gjithë Shqipëria do të përfshihej në shfarosje. Në këtë tmerr lufte, i cili solli emigrimin e madh të shqiptarëve nga jugu e veriu i Arbërisë, për në mbretërinë e Napolit, Italisë, Republikës së Venedikut dhe Dalmacisë, emigroi edhe afresku i “Zojës së Këshillit të Mirë”, duke u shkëputur nga muri i Kishës bri kalasë Rozafat, nga Kisha “Zoja Nuncijatë” (Lajmërimin të Zojës) dhe zuri vend në vitin 1467 në afërsi të Romës, në Gjenacano.

Mehmeti II, deri kur iu vërsul Arbërisë Venedikase me një furi të paparë, Ulqini dhe Tivari, ishin të mbrojtur nga malet dhe flota venedikase, kështu që hoqën vetëm tmerrin psikologjik, deri kur së fundi në vitin 1571, pas sulmeve të furishme të osmanëve ranë në pushtetin osman. Kështu Arbëria pas një qëndrese njëqindvjeçare (1385-1479) u përfshi në sistemin e Perandorisë Osmane.

Zhvendosja e afreskut të “Zojës së Shkodrës” në vitin 1467 në Gjenacano

Vërehej bri kalasë së qytetit të Shkodrës, mbi një kodër, një kishë e vogël ku nderohej një figurë çudibërëse e Marisë tejet e shenjtë, e pikturuar në mur, që mbante emrin “Zoja e Këshillit të Mirë”. Para saj ishte lutur shumë herë, heroji kombëtar, Gjergj Kastrioti dhe kishte marrë atë shkëndijë trimërie dhe zjarri, falë të cilës, në mes të betejës dhe flakëve, ngjante si Hyji i luftës. Shkodranët i drejtoheshin po Asaj figure për t’iu lutur që të largonte fatkeqësinë e shkaktuar nga Perandoria Osmane. Në afrimin e paepur të fatkeqësisë turke, shumë prej tyre nuk dinin ku tjetër të gjenin shpëtim, veçse te kjo figurë dhe duhej të kërkonin jashtë atdheut, në vende të huaja, sigurinë e një jetese të vështirë prej mërgimtari. Para se të merrnin rrugën e mërgimit, shkodranët shkonin të pikëlluar që t’i kërkonin ndihmë Zojës së tyre, që me keqardhje duhej ta linin vendlindjen në duart e njerëzve të egjër dhe brutalë dhe i luteshin për të fundit herë që t’i shoqëronte me bekimin e saj në të panjohurat e mërgimit. Mes këtyre mërgimtarëve dalloheshin për mëshirën e tyre dy vëllezër katolikë, Giorgius dhe De’Sclavis të pikëlluar thellë për fatet e ardhshme të atdheut të tyre. Në librin e protokollit vjetor gjendet sinonimi Georgeus Albanensis, habitator Jenazzani. Mandej, po aty, shënohet ardhja e tij në prill të vitit 1467 dhe se u martua më një të vejë me emrin Contadina, duke lindur katër djem: Markun, Fabricin, Kolën e Nushin. Pema e gjenealogjisë së Giorgius, figuron nga fillimi i vitit 1467 dhe shkon deri në vitin 1898. Shqiptari tjetër, De Sklavis (Sclavis) Shtëpia e Sklavit, ishte i mirënjohur në Gjenazano deri në vitin 1778. Shumë lokale në Gjenacano kanë mbajtur emrat: de Sclavis, dello Schiavo, Schiavella, etj.

Nëse i referohemi aspektit teologjik, afresku i Zojës në mënyrë të mrekullueshme ishte shkëputur nga muri dhe figura duke iu paraprirë dy rojeve, Gjergjit dhe Sklavis, duke kaluar

detin e Adriatikut, më 25 prill 1467, kishte zënë vend afër Romës, në Gjenacano. Por, nëse i referohemi anës studimore, atëherë themi se, në valën e sulmeve shkatërrimtare turke, për ta shpëtuar këtë vepër unikale nga dëmtimet, ajo që shkëputur nga muri i Kishës e bri Rozafës dhe në mënyrë të mirë koordinuar me familjen mbretërore Colonna të Lazios, e cila këtë figurë, më vonë, do ta mbante si pronë të veten, atë që mbartur nga Shkodra për në Gjenacano, në kuvendin ku shërbenin nderit eremitë agustinianë. Pas arritjes së figurës, vejusha e pasur Petrucia, duke shprehur nderimin ndaj “Zojës së Bekuar”, kishte marrë iniciativën për ngritjen e një kapele të veçantë për figurën e “Zojës së Këshillit të Mirë” e ardhur nga Shkodra, punimet e së cilës kishin përfunduar pas vdekjes së saj.

Figura e Zojës së Shkodrës, edhe pas shpërnguljes për në Gjenacano, vazhdonte të shpërndante hire mrekullibërëse nga shtëpia e saj e re, e posa ndërtaur. Ishin të shumta dhe kaq të jashtëzakonshme mrekullitë, sa që u desh të merrej “Selia e Shenjtë” që të shqyrtonte, të vërtetonte dhe t’i regjistronte zyrtarisht ato. Zëri i një shfaqjeje të mrekullueshme të Virgjëreshës në Gjenacano, që arriti deri në Romë, e bëri papa Palin II, që në vitin 1467 të ngrejë një komision, të përbërë nga Imzot Gaitan Marini, Kalisto Marini etj., i cili në bazë të studimeve të kryera, do shprehej se, “Figura e Zojës” është mrekullibërëse. Këtë figurë, si të tillë, e kanë konsideruar edhe papë të tjerë në vitet në vazhdim: Siksto IV, 1475; Urbani VIII, 1630; Benedikti XIV, 1753; Pio IX, 1854; Leoni XIII, 1883; Gjoni XXII, 1959; e deri tek papa Gjon Pali i II, më 25 prill 1993, me rastin e ardhjes së tij në Shqipëri.

Afresku i Virgjëreshës dëshmohet se është nga Shkodra

Për lidhjet e kësaj figure me Shkodrën flet papa Benedikti XIV në bulën e tij, “*Iniunctae Nobis*”, më 2 korrik të vitit 1753, ku ndër të tjera do shprehej, se: “*Figura siç thotë gojëdhëna e devotshme, me shërbesë të engjëjve, ishte bart prej qytetit të Shkodrës e çua në Gjenacano*”. Për shpërnguljen e figurës për në Gjenacano flasin shumë etër agustinianë në shekullin XV-XVI, si: Koriolani, Panfili ipeshkëv i Senjit, Kruzeni, Erreri, Torelli, 1630; Elsi, Feroce, 1713; etj.; P. Angelo Maria de Orgio, 1748; Pietri Pompilio Rodota, 1770 etj. Gjenerali i urdhrat të agustinianëve, pater Nicolantonio Schiaffinati, i cili në vitin 1730, duke iu përgjigjur Papa Klementit XII, shprehet se “*Zoja kishte bërë një udhëtim të gjatë nga Shqipëria për në Gjenacano*”. Një autor tjetër, nga Gjenacano, Senni, në veprën e tij shprehet “*Memorie di Genazzano e dei paesi vicini*”, në vitin 1779, duke përdorur dokumente të kohës, vepra, letra personale e përshkruan hollësisht historinë e ardhjes së figurës nga Shkodra si dhe ngjarjet në vazhdim të ndodhura në Shenjtëroren e Gjenacanos. Të vërtetat për ngjarjen në fjalë nxirren edhe prej dëshmimeve të marra nën betim, nga pleqtë e Gjenacanos, të cilët vazhdimisht janë regjistruar me korrektësi prej komisioneve të “Selisë së Shenjtë”.

Një rol shumë të rëndësishëm për publikimin e kësaj ngjarje, patën arbëreshët e Italisë të shpërngulur në vitin 1461, në 1467, në 1471, në 1479 dhe 1744, nga jugu dhe veriu i Arbërisë, të cilët kishin zënë vend në Kalabri e Sicili dhe në vendbanimet e reja, si: Lazio, Pulia, e Venecia, për shkak të dhunës së ushtruar nga pushtuesit osman, me rastin e luftërave të zhvilluara për ruajtjen e trojeve Arbërore. Ata ruajtën ndër shekuj kujtimet e lavdishme të shek. XV, të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti, si dhe ngjarjen e zhdukjes së afreskut të “Zojës së Këshillit të Mirë” nga kisha e Shkodrës, dëshmi kjo e lidhjeve të thella shpirtërore e kulturore që kishin pasur me luftën e shqiptarëve në mbrojtjen e atdheut prej furisë së pushtimit osman. Arbëreshët, duke rikujtuar dëshmitë e të parëve të tyre, mbanin një devocion të shtuar dhe të jetuar me të shenjtëruarën Virgjëreshën Mari. Ata në këtë mënyrë u bënë protagonist të vyer në zbardhjen e ngjarjes rreth shpërnguljes së figurës murale të Zojës nga Kisha rrëzë kalasë së Shkodrës, në vitin 1467, për në Gjenacano, Itali. Kudo që gjendej një koloni arbëreshe, vërehej një figurë, o një altar, apo një Kishë, kushtuar “Zojës së Këshillit të Mirë”. Dëshmitë e arbëreshëve (katolikë të rritit bizantin) në këtë drejtim janë të shumta nga ata të shpërngulur në

provincën e Kalabrisë dhe Sicilisë. Për këtë rast në librin i Imzot G. Dillon, kemi shënime të zgjeruara rreth përkushtimit ndaj Zojës së Shkodrës, nga familja Rodota, e cila i takonte shtresës klerikale, ku në mesin e tyre do veçonim: Don Stefano Andrae Rodota, Don Maurizio, Don Luigi, 1738, Don Samuelle Rodota etj. G. Dillon nga e gjithë kjo familje, veçon kontributin e shquar të dhënë nga Don Stefano Andrea në vitin 1713, misionar fort i zellshëm nga Kalabria. Ai e kishte me shumë përzemërsi përshtipërinë ndaj Zojës së Shkodrës, duke e përhapur nderimin ndaj saj ndër të gjithë arbëreshët. Stefano, njëherazi është angazhuar, së bashku me ipeshkvin vendor të ritit bizantin të “Selisë së Shenjtë”, që emri i “Zojës së Këshillit të Mirë” të përfshihej zyrtarisht në ritualet kishtare. Don Stefano, në relacionet e tij, ka pohuar me krenari për prejardhjen e afreskut të “Zojës së Shkodrës”, nga Arbëria për në Itali, e cila për shkak të pushtimeve të egra turke të trojeve shqiptare, në vitin 1467, qe shkëputur nga kisha e “Zojës Nunciatë” dhe dërguar në Gjenacano.

Një person tjetër me gjak arbëreshi dhe me peshë të lartë kishtare, ishte kanoniku i bazilikës së Shën Markut në Romë, Andrea Bacci. Ai, më 2 shkurt të vitit 1748, në një promemorie drejtuar autoriteteve papate shpalosi bindshëm dëshmitë për mrekullitë e ndodhura nëpërmjet figurës së Gjenacanos dhe njëherazi më gjithë autoritetin kishtar që kishte, ka përhapur në zonat arbëreshe, nderimin ndaj kësaj figure mrekullibërëse. Kuptohet qartë, kanoniku Bacci, sesa ka qenë i përkushtuar ndaj “Zojës së Shkodrës”, pasi me rastin e vdekjes së tij, ishte ngritur në Gjenacano një epigraf për të, (pllakë përkujtimoreje), në vitin 1758, ku ndër të tjera ka qenë shkruar se “*Shpirti e tij qe kushtuar Zojës së Gjenacanit*”. Edhe shkrimtarët arbëreshë, të cilët më shkrimet e tyre shpalosnin shpirtin e këtij populli, qenë frymëzuar nga historia e “Zojës së Shkodrës”. Jul Varibobba, (në vitin 1762, tek “*Ghella e Shën Mërisj Virghjer*” ia ka kushtuar dy poezi Zojës së Këshillit të Mirë. Pastaj kemi Atë Leonardo de Martino, me poezinë e publikuar në “Misionet Katolike”, Milano, 18: “*Oh! Hyj!... kaluan tashmë shumë vite vetmie...*”. Mendohet se më parë kanë thurur lavde dhe Nikollë Filja (1691-1769) edhe Nikollë Brankati, (1675-1741). Nga Shqipëria kemi poezitë e Atë Vinçenc Prennushit, Atë Gjergj Fishtës, Dom Ndre Zadejës etj. Shqiptarët e Venedikut, duke qenë se ishin shpërngulur nga qyteti i Shkodrës e nga rrethinat, e kanë ndier më shumë se askush tjetër mungesën e “Zojës së Shkodrës”. Ata të cilët shumica kishin arritur të kenë një rol të rëndësishëm në Republikën e Shën Markut, që në shek. XV, mbledheshin për ta nderuar Zojën, të cilën e quanin “Zoja e jonë e Shkodrës”. Nderimi ndaj “Zojës së Këshillit të Mirë”, në Evropë, qe përhapur përveç se në Itali dhe në Spanjë, Gjermani, Austri e Belgjikë si dhe në kontinentin e Australisë dhe Amerikës. *Zoja e Parajsës*, siç del e shënuar në disa dokumente, iu janë kushtuar shumë kisha dhe kuvende të rregulltarëve të ndryshëm.

Dëshmitë e autoriteteve kishtare në Arbëri në shek. XVIII-XIX

Ngjarja për shfaqjen e Zojës në Gjenacano, tashmë ishte e njohur mirë në gjithë Italinë dhe Evropën. Është tejet e drejtë të pohohet se Shkodra, për shkak të pushtimit turk, kishte arsye të mbante këtë ngjarje gjithnjë në heshtje. Popullata gjatë periudhës së rrethimeve të pësuar prej Perandorisë, braktisjeve, torturave, islamizimit tronditës, ishte e pamotivuar. Por, një ngjarje si ajo e nisjes së “Figurës së Shenjtë”, shenjë kaq ogurzezë, duhet të ketë hyrë thellë në shpirtat e shqiptarëve të pikëlluar, që nuk kishin mundur të emigronin. Ata që kundërshtonin të mohonin besimin e etërve të tyre, duhet të jenë mbledhur tok pikërisht rreth këtij besimi.

Turqit mund të dëshironin që të provohej nisja e “Figurës së Shenjtë”, por i druheshin të krishterëve dhe kishin synime të tjera. Nganjëherë, për arsye politike, ruheshin tregtarët dhe artistët e krishterë dhe prania e tyre bëhej e rrezikshme. I tillë ishte rasti i ndodhur për një kohë të gjatë në kalanë e Shkodrës, njëra nga kalatë më të rëndësishme të Shqipërisë. Të gjitha

kërkimet që kishin të bënim me çështje fetare ishin të shtypura. Në këtë mënyrë, gjatë pushtimit të qytetit të bërë nga turqit, që absolutisht e pamundur të mësohet ndonjë informacion të kishite lidhje me kishën e vogël të braktisur nga figura e mrekullueshme.

Pasi shqyrtimet e dëshmitarëve të ndryshëm, si: rojtarët e zellshëm të Shenjtores së Gjenacanos, autoritetet e larta kishtare në Romë, tani kërkoheshin prova të reja. Por, gjatë gjysmës së shekullit të XVIII, kjo mbikëqyrje e turqve, megjithëse përherë e rreptë, pati një lloj lehtësimi dhe i lejoi të dërguarve të misioneve katolike në Arbëri, që të japin të dhëna tejet të rëndësishme që kanë të bëjnë me Zojën e Gjenacanos.

Rrëfimi i parë i dhënë vinte nga fisniku shqiptar, Kont dhe Kapiten Stefano Medin, që me 25 korrik të vitit 1745 ia drejtoi zotërisë, Kontit Giovanni Battista Medini, si dëshmitari i ngjarjes rreth objektit të kishës së “Zojës” së Shkodrës. Ky dokument i botuar nga P. Angelo Maria De Orgio, në vitin 1748, hedh një dritë të madhe mbi faktin, që figura e nderuar që në kohë të hershme në Gjenacano; nuk ishte tjetër veçse e njëjta e Giorgit dhe e De Sclavis-it e paraqitur si kishë (objekt kulturi) e veçantë nga ana e Skënderbeut dhe e gjithë Shqipërisë. Pastaj thuhej, se sot ky objekt i rrënuar ka një rrugë të dytë prej së cilës ishte nisë qëkur figura e Zojës së nderuar dhe se aty bëheshin mrekulli të shumta.

Pastaj kemi dëshminë e zotit Nikolla (Kola) i Anton Kambsi-t, fisnik i qytetit të Shkodrës, i cili që ftuar në festën jubilarë për Kanunizimin e Shën Pjetrit, në Romë, më 9 shkurt të vitit 1748. Pasi e pa prelati, Antonio Giuli-Mondi, qytetar i Gjenacanos, u shty nga kureshtja për të pyetur se nga ishte i përmenduri Nikolla, pasi ishte i veshur sipas kostumeve të Shqipërisë. Por, meqenëse ai nuk dinte akoma të fliste në gjuhën italiane, u përgjigj nëpërmjet Abatit, Dom Gaspare Azurri, me të cilin shoqërohej për në Romë. Z. Nikolla dha njoftimet e nënshkruara. Ai deklaroi se kisha ku nderohej më parë figura në fjalë, ekzistonte para se Shkodra të binte në dorë të turqve. Kisha e vendosur jashtë qytetit nderohet për së tepërmi nga katolikët edhe gjatë të së kaluarës. Sot kjo kishë është rrënuar. Aq më shumë se në një mur shihet qartë se ku kanë qenë figurat edhe të shenjtorëve të tjerë. Z. Nikolla, në Gjenacano, ka parë portretin e asaj Virgjëreshe, që është me të njëjtën madhësi dhe pamje me atë në Shkodër. Ai ka pohuar se përkon me pjesën e zhveshur të lënë në mur të Shkodrës, megjithëse pjesërisht e prishur nga pabesia e turqve. Kisha në fjalë, ka pohuar Nikolla, se është nën pushtetin e turqve, të cilët nuk i lejojnë katolikët të hynë brenda mureve të rrënuara. Sipas Nikollë (Kolë) Kambsit, Kisha tani rrënuar, ishte bërë më tre dhoma dhe se ajo e mesmja kishte disa gunga dhe pa asnjë shenjë pikturimi në krahasim me dy dhoma të tjera, në të cilat dalloheshin gjurmët e pikturave të ndryshme. Kambsi jep edhe disa shënime të tjera për gjendjen e këtyre rrënojave, për të cilat po kështu, flasin edhe autorët e tjerë të mëvonshëm. Z. Nikolla pohon se katolikët e qytetit, tregojnë se një turk, mes atyre të pabesëve, me titull në gjuhën e tyre “Efendi” duke dashur të kthente Kishën në Xhami, nga afërsia e shtëpisë së tij me vetë kishën, i ngjitur sipër në një shkallë të murit për të thirrur popullin turk që të bënin tek rrënojat e Kishës shërbesat sipas sektit të tyre, po në atë çast iu kthye e gjithë fytyra mbrapsht; dhe pasi filloi të klithte si një cjan, u ul dhe hoqi dorë nga shkatërrimi i mureve dhe përpjekja e shndërrimit të objektit në xhami. Në të njëjtën mënyrë pohon se si jo shumë vite më parë, një tjetër turk njësoj si i pari, i quajtur Vegliada Zerde, për të bërë një urë në lumin Buna, në afërsi të kishës në fjalë, meqenëse kishte guxuar të hiqte nga muri i asaj Kishë gurët dhe i kishte ngarkuar në disa mushka, i transportoi në lumin në fjalë; sapo i shkarkoi dhe i grumbulloi këta gurë, mushkët u rrëzuan dhe ngordhën në vend. Megjithëkëtë duke këmbëngulur në atentatin e tij, e ndërton urën në fjalë, e cila sa u ndërtua ra e u shkatërrua krejtësisht; pas kësaj që ndodhi turku në fjalë i çoi edhe një herë gurët tek kisha; dhe i la në tokë pranë murit të kishës deri sa u nis nga Shkodra, pak a shumë prej tre vitesh. Dhe është aq e madhe frika që kanë ata të pafe nga dështimet e lartpërmendura, saqë as nuk guxojnë të prekin disa pemë pranë një kishë tjetër, jo larg nga ajo. Tentime të tilla shkatërruese ka pasur në kohën e Çaushëve të Shkodrës, në vitin 1740, deri me ardhjen në pushtet të Bushatlijve në vitin 1757, ku përveç që i dhanë qytetit të Shkodrës

shtatëmbëdhjetë vjet jetë “pa frikë e ankth” ditën t’i tregojnë Çaushtëve të kohës, se shqiptarët edhe pse me fe të ndryshme janë të detyruar të jetojnë së bashku.

Për ekzistencën e Shenjtërores kemi dëshmi edhe të autoriteteve të larta kishtare në Shkodër. Ipeshkvi i Shkodrës, Imzot Pal Kamsi, me rastin e një vizite në Romë, më 25 shtator 1754, pati shfrytëzuar rastin për të celebruar një meshë në Gjenacano, në shenjë nderimi dhe përmallimi ndaj afreskut të Zojës së Shkodrës. Më këtë rast para eproreve agustinian pati dëshmuar për shpërnguljen e kësaj figureje nga Shkodra në Gjenecano, gjatë pushtimit osman. Në këtë vizitë Kamsi që i shoqëruar nga Dom Ndoc Borsi dhe Dom Gjon Kabashi. Kurse në një rast tjetër nga Dom Ndoc Logoreci e Dom Shtjefen Prendagni. Po të njëjtën dëshmi e jep dhe me shkrim në relacionin e tij të vitit 1757, që ia dërgon Propagandës Fide në Romë. Por, në krahasim nga të tjerët, Kamsi, shprehet se vendi nga është shpërngulur afresku është Kisha e “Shën Magdalenës” në Kazem, përtej lumit Buna, e jo rrëzë kalasë. Po i të njëjtit mendim është dhe ipeshkvi tjetër i Shkodrës, Gjergj Radovani. Ai në një relacion të 27 majit 1780 që ia drejton Propagandës Fide, në Romë, ndër të tjera thotë se “*Kisha e moçme e Shën Magdalenës që gjendet kah ana tjetër e lumit Buna në Malin e Kazenës, ndahet për shenjë prej tjerave, pse besohet se prej këtu është shkukur si për mrekulli dhe ka shkua në Gjenacano figura e Shenjt e Zojës së Këshillit të Mirë, dhe populli më 22 korrik merr mëshirën e plotë në këtë vend*”. Të dyja shkrimet e lartpërmendura rreth vendndodhjes së figurës më duken si të pavendosura dhe të paqarta deri në fund. Kisha e “Shën Magdalenës” si vend kult, vërtet ka qenë shumë e njohur në tërë dioqezën, sepse në momente të caktuara aty banonin ipeshkvijtë e Shkodrës, për shkak të ndalimit nga turqit që të veprojnë nga zemra e qytetit; por shënimet e Kamsit dhe Radovanit mbeten të vetmuara dhe të paargumentuara sa duhet në shumë aspekte.

Interes për afreskun e Zojës së larguar nga Shkodra, me kërkesën e etërve agustinian ka treguar, kryeipeshkvi i Shkupit, Imzot Gjon Nikollë Kazazi, i cili në një letër të 15 tetorit 1745, njofton se, me ndihmën e misionarit françeskan, P. Bonaventura, personalisht ka vizituar rrënojat e Shenjtore, në lagjen e Ali Mahalasisit, ku sipas Hamdi Bushatit është lagja Alibeg – Ajasëm. Kazazi, ndër të tjera shprehet se, bojërat e pikëzimit (pikturimit) që tani ishin leskra, të cilat shiheshin në muret gjysmë të rrënuar, ishin të njëjta me ato në Gjenacano. Po kështu, etërit agustinian kërkojnë mendim edhe nga kryeipeshkvi i Durrësit, Rafaele D’Ambrosio. Ai në një letër të vitit 1875, ndër të tjera dëshmon se edhe shqiptarët e islamizuar, në sajë të historisë së ndodhur, nderojnë figurën e “Zojës së Këshillit të Mirë”. D’ Ambrosio, merr shembullin e shqiptarit të islamizuar, Ali Kokut nga Karica e Matit, i cili me fanatizëm e ruante figurën e Zojës si trashëgimi nga të parët e tij.

Pra, as Kazazi e as D’ Ambrosio, nuk e zënë në gojë si vend largimi të mundshëm të figurës së Zojës nga Kisha e “Shën Maria Magdalenës”, aq me tepër kur ajo kishë ishte funksionale, ndonëse pa çati të rregullt siç shprehet, në një relacion të vitit 1745 Imzot, Pal Kamsi. Për sa i përket vendndodhjes së “Kishës së Zojës” ku ndodhi mrekullia, tani pranohet versioni i zyrtar që jep vikari i përgjithshëm i dioqezës së Shkodrës Engjëll Radoja, i cili në vitin 1878 pohonte se Kisha prej nga është shkëputur figura e Zojës, gjendet në këmbët e kështjellës së Shkodrës në mes lumenjve Buna dhe Drini. Shihet qartë se Radoja, krahas Kazazit, D’Ambrosios, misionarit P. Giampieros, me të drejtë anashkalojnë relacionet e Kamsit e Radovanit, në lidhje më vendndodhjen e saktë se nga është shkëputur afresku i “Zojës së Shkodrës”.

Kërkimet e shekullit XVIII, vijuan me lehtësi të madhe dhe me rezultate tejet të mira gjatë shekullit të XIX, kur eprori i lartë agustinian Pietro Belgranos Agna, më 8 korrik 1878, kërkoi formimin e një grupi pune nga qarqet kishtare, që do kryente studime më të reja në rrënojat e “Kishës së Zojës” bri kalasë Rozafat, në Shkodër. Komisioni u krijua nga Arqipeshkvi i Shkodrës dhe i Tivarit, Imzot Carlo Potten me këtë përbërje: Atë Gianpiero Ferrari Da Bergamo, Prefekt Apostolik të Misioneve të Kastratit dhe Epror të Hospicit të Françeskanëve në Shkodër; Imzot Engjëll Radoja, Mëkëmbës i Përgjithshëm të Arkidioqezit

të Shkodrës; Dom Pashko Junku, zv. famullitar i Shkodrës, të shoqëruar nga fra Anselmo Gorle, arkitekt dhe njohës i mirë i traditës popullore. Pas vëzhgimeve dhe kërkimeve të hollësishme në lidhje me çështjen, më 16 korrik 1878, u hartua një tekst i gjatë i nënshkruar nga personat e lartpërmendur dhe i vulosur nga Carlo Potten, ku u dha analiza e hollësishme për vendin e gërmadhave bri kalasë Rozafat nga ku ishte zhvendosur për në Gjenacano, Itali, në vitin 1467, figura e Zojës së Këshillit të Mirë. Kjo analizë përputhej me të dhënat e publikuara më parë nga shqiptarët në mërgim dhe krerët e lartë kishtarë nga Shqipëria.

Në vazhdim po japim disa informacione të çmuara të grupit të punës të lartpërmendur të dt. 16. korrik 1878, të kryesuar nga fra Giampiero da Bergamo, lidhur me traditën dhe faktet historike që kanë të bëjnë me kishën dhe kultin kushtuar “Zojës së Shkodrës”.

Në raport, ndër të tjera, thuhet se vendi ku janë ato rrënoja është vërtet ai dhe i vetmi, në të cilin tradita dhe kujtesa historike e Fra Agelo Maria De Orgio, si dëshmitar okular, në vitin 1748, kishte dëshmuar për fatlumen “Zojën e Shkodrës”. Komisioni dëshmon se është i njëjti qytet, pra Shkodra, vendi për të cilin flasin dëshmitë e shtegtarëve Giorgio dhe De Sclavis, në Gjenazano. Në hetimet e hollësishme vihet re se, dhoma në mes (ndërtesa është e përbërë nga tre dhoma) dallohet nga të tjerat anësore si nga madhësia, ashtu edhe nga stili, nga dyert dhe nga dy dritaret e veçanta në dy muret në krah dhe se në murin kryesor të vetë asaj janë tre nike katrore (kamare), në të cilin më e vogla është në mes dhe përkon saktësisht me portën e hyrjes, që akoma vihet re të ketë qenë në murin qendror, i cili pjesërisht ekziston akoma. Në vazhdim të përshkrimit thuhej se “*Sipër nikes së vogël në mes të murit ruhen ende shenjat e një harku, domethënë të një harku si në formë zbukurimi të vetë nikes. Se duke parë dritaret e vendosura në mes të dy anëve të dhomës, si edhe dy dyert e ndodhura në mur, ku ishte porta hyrëse dhe nëpër të cilat kalohet në dy dhomat e tjera anësore, kanë për arkitra një hark me majë të stilit gotik*”. Pastaj dëshmohej se, “*muret e dhomës në fjalë kanë aty-këtu ende shenjat e një suvaje prej stukoje të shndritshme dhe të kuqërremtë*”. Flitet edhe për pjesët dytësore të rrënojave duke u shprehur se “*Dy dhomat anësore janë plotësisht të ngjashme si në madhësi, ashtu edhe në formën e portave me harqe me majë, si në mungesën e nikeve dhe boshllëqeve të tjera të bëra në mur*”. Në vazhdim thuhej se: “*Kjo na ka bindur se ajo dhomë në mes ishte në përdorim si Kishë dhe dy dhomat anësore kanë shërbyer si tribunë, ku mund të mbledheshin besimtarët në ditët e urdhëruara apo të festës*”.

Analistët japin mendimin e tyre edhe sa i përket lashtësisë së rrënojave të Shenjtërores se dikurshme duke u shprehur se, ato i përkasin një kohe më të mëparshme se sa pushtimi i turqve, pos formës së ndërtesës, për të cilën nuk takohen të tjera të ngjashme në asnjë vend tjetër të Shqipërisë dhe për ngjyrën e kuqërremtë dhe të errët të gurëve, me të cilët është ndërtuar Shenjtërorja në fjalë. “*Për këto të dhëna të qarta dhe shenja që plotësisht përputhen me lajmet e dhëna nga historianë të mirëfilltë jemi njëmendje në deklarin, se ato rrënoja janë mbetjet e kishës një herë e një kohë zotëruese e Figurës së Lume të Gjenacanos*”.

Në vazhdim po japim edhe disa detaje interesante që ishin të pa njohura më parë, për historianin De Orgio-s, të Buonanno-s dhe të tjerëve, të mbështetur në librin e Giorgio Dillon.

Nga shënimet e Giampiero da Bergamo, më 26 shkurt 1879, mësojmë se turqit i respektonin ato mure dhe nuk guxonin t’i preknin nga frika se do të ndëshkoheshin rëndë, siç u ndëshkuan etërit e tyre, kur guxuan ta përdhosnin, sepse ishte tradita e atij vendi e cila dëshmonte se, nuk mund të përdhosej ai vend pa u shkakuar me ndëshkime Hyjnore. Në atë kohë ende ishte e gjallë dhe e fuqishme, mes popullsisë myslimane të Shkodrës, tradita e ndëshkimit nga Zoti (Allahu) për myslimanët. Në shenjë nderimi ndaj “Figurës së Zojës” së larguar nga këto rrënoja, Giampiero da Bergamo, nga dëshmitarët mëson, se në shtegtimet e shumta të besimtarëve në ato mure të nderuara, e kishin zakon të silleshin disa herë rreth tyre, dhe të puthnin në çdo xhiro një figurinë të Zojës të gdhendur në një gur, që ishte e vendosur në faqen e jashtme të murit ku ndodhej Nikja, që mbante njëherë e një kohë të Lumen Figurë të Gjenacanos. Dëshmitarët rrëfenin, se “*Figura e gdhendur, ishte e përafërt me atë që nderohet*

në Kishën Katedrale të Shkodrës". Tha pastaj se *"Me keqardhjen e saj të madhe, rreth dy vite pas kësaj periudhe, nuk e gjeti më atë figurë, dhe mendoi se ndonjë besimtar i Zojës e kishte hequr nga muri, dhe e kishte marrë atë gur mbi të cilin ishte gdhendur figura"*.

Shënimi tjetër me interes vjen nga Pashko Junku, famullitar i "Katedrales së Shkodrës", i cili pohonte se *"Ka parë, pak vite më parë një gur të punuar me daltë, me formë të zgjatur dhe katër këndore, mbi të cilën ishte i gdhendur me shkronja të mëdha shkrimi i kushtimit– D. O. M. Et Beatae Virgini-*". Në vazhdim thuhej se *"Ai gur ishte që me kohë i rrëzuar përtokë jo larg rrënojave të përshkuara më sipër dhe fatkeqësisht u hoq pak kohë më parë nga myslimanët dhe u përdor në restaurimin e urës mbi lumin Drin"*.

Në vijim kemi dhe një detaj që lidhej më rrënojat, të mbledhur në terren nga Engjëll Radoja me 6 tetor 1879. Besimtarët të cilët kryesisht jetonin në: Zues, Tebunë, Berdicë, Kuç dhe në Rrmaj, vende shumë afër qytetit, në muret e rrënojave, me admirim dhe nderim kanë *"puthur disa herë një gur me madhësinë e një pëllëmbë, në mes të së cilit dukej e gdhendur, megjithëse e konsumuar nga koha, Figura tejet e Shenjtë e së Lumes Virgjër Mari me Djalin e saj Hyjnor, Jezusin në gj"*.

Krahas analizave të hollësishme të bëra nga komisioni i lartpërmendur, duke marrë parasysh se ka pasur nga pushtuesi turk tentime për ndërtime të reja brenda ambientit të rrënojave, superior agustinian, Pietro Belgrano Agna, i nxitura nga jezuiti Atë Karlo Vasilico, në rolin e një mendimtari ndryshe, kërkonte edhe ca shënime shpesh rreth rrënojave në fjalë. Belgrano më 10 gusht dhe 17 shtator, 1878, i shkruan Atë Mariono Pizzachini Palmonova, Prefektit Apostolik Françeskan për Misionet Epirit në Shqipëri, duke shtruar pyetjet se deri në çfarë mase ka pasur ndërhyrje ndërtimore private në muret e Kishës së "Zojës së Këshillit të Mirë" dhe çfarë mund të thuhet për gjurmët e pikturave në muret gjysmë të rrënuara? Por përgjigjja ishte nga Komisioni i sipërpërmendur se, turqit nga frika e fatkeqësive, kishin heqë dorë nga mendimi për t'i kthyer ato rrënoja në xhami, dhe për të vënë dorë në dëm të saj. Pastaj është konstatuar se, nuk ka pasur asnjë, as të krishterë, as myslimanë që mbajnë mend ndonjë ndërtim shtëpie, apo tjetër ndërtesë me qëllim shekullar apo fetar.

Letrat në fjalë të gjetura dhe të përkthyer nga Atë Shtjefën Gjeçovi përmbanin dhe shënime të tjera. Nga letra e parë, do veçonim informacionin e mbështetur në botime gjermane, se në vitin 1856 një delegacion nga Shkodra, kishte kërkuar nga papa Pio IX, për t'iu dhënë figurën e Gjenacanos dhe për ta kthyer në Shkodër nga ishe marrë. Por në këtë rast Papa kishte dhënë një kopje të saj të realizuar nga piktori bavarez Michel Wittmer, e cila në vitin 1859 qe sjellë në Shkodër. Për këtë provë flet edhe Gjush Sheldija, i cili shprehet se, pas një përdorimi të gjatë, kjo pikturë nuk dihet se ku kishte humbur dhe në kohën e Jak Serreqit, kur ishte famullitar i Shkodrës (1898-1905), qe sjellë një pikturë e re nga Italia.

Si përfundim, nëpërmjet këtyre shënimeve të zbardhura nga komisioni dhe atyre të mëparshme për kujtesën historike, dëshmohet se tradita në Shqipëri ishte e njëjtë krejtësisht me dëshmitë e shtegtarëve Giorgio dhe De Sclavis në Gjenazano, por edhe nderimi në popull ndaj Virgjëreshës që mbijetonte për pesë shekuj më radhë. Vetë muret e shenjtërores, në të cilën gjendej më parë figura, mbaheshin si të shenjta dhe kur turqit i lejonin, banorët e zonave përreth mbledheshin në shtegtim. Për më tepër dukej sikur asnjë pushtet turk nuk arrinte të kthente këtë tempull në Xhami. Muret dukeshin sikur ruheshin nga një fuqi mbinatyrore. Populli besonte fort në shumë mrekulli e ngjarje të mbinatyrshe që ndodhnin në ato gërmadha.

Historia më e thelluar deri në vitin 1879, rreth Shenjtërores së Gjenacanos, figurës së mrekullueshme dhe lidhjeve të ngushta që ky afresk ka me Shkodrën dhe popullin shqiptar, është pasqyruar më së miri në librin e ipeshkvit të Sidnev, (Australi) misionarit apostolik, Mons. Giorgio Dillon, *"La Virgine Madre di Buon Consiglio"*, (përkthyer nga anglishtja nga Giuseppe Pifferi), 1892.

Nxitjet dhe përballja në rindërtimin e Shenjtërores

Reformat centralizuese të zbatuara në Perandorinë Osmane, për ta shpëtuar atë nga dobësimi i mëtejshëm nuk kishin dhënë rezultat të pritshëm. Si rrjedhojë, në fillim të viteve 70 të shek. XIX gjendja politike dhe ekonomike e kësaj Perandorie ishte keqësuar më tej. Kryengritjet popullore e sidomos atyre në veri të Shqipërisë, kundër shtypjes osmane, ishin përhapur pothuajse në të gjitha trevat shqiptare. Edhe gjendja ndërkombëtare e Perandorisë Osmane e bë edhe më e rëndë. Dy superfuqitë evropiane, Rusia dhe Austro-Hungaria, ishin për shembjen e saj dhe ndarjen e Ballkanit sipas interesave të tyre. Derisa Rusia do rriste ndikimin në Ballkan me flamurin e pansllavizmit, Austro-Hungaria ishte kundër shteteve sllave ortodokse, duke iu kundërvënë atyre me fuqizimin e shteteve katolike, që mbanin për qendër shpirtërore të tyre Romën. Gjatë Krizës Lindore, shqiptarët i kuptuan rreziqet që kërcënonin atdheun e tyre, prandaj vendosën të qëndronin në pritshmëri dhe t'i ndiqnin me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve nacionale, politike e fetare.

Pasi kisha katolike nën Perandorinë Osmane kishte pësuar goditje të rëndë shkatërrimi, marrëveshja e Protektoratit të Kultit e vitit 1837, e nënshkruar nga Vjena e Roma, përmbante ndër të tjera, të drejtën e rindërtimit dhe ndërtimin e objekteve katolike në trevat shqiptare. Për këtë arsye çështja e protokultit ishte temë diskutimi e vazhdueshme në marrëveshjet luftarake ndërkombëtare në mes Austro-Hungarisë e Perandorisë Osmane.

Nisur nga ky fakt situata për shqiptarët paraqitej si një shans i mirë për rimëkëmbjen e disa objekteve fetare. Me ndihmën e Austro-Hungarisë u ndërtua në vitin 1857, Katedralja e Tivarit, kushtuar “Zojës së Papërlyer”; në 1865, katedralja e Shkodrës kushtuar “Zojës së Këshillit të Mirë” dhe në vitin 1875 ajo e Prizrenit kushtuar “Ngritjes së Zojës në Qiell”. Gjatë periudhës 1884-1894, shënohej një përkeqësim i marrëdhënieve me pushtuesit turq, duke vendosur përkufizime për ushtrimin e besimit dhe duke ndaluar rindërtimin e kishave të rrënuara. Por, pas trysnive që bëheshin nga konsullata Austro-Hungareze në Shkodër, situata deri diku zbutej dhe marrëdhëniet me Perandorinë Osmane merrnin një kaheje qetësimi.

Nisur nga ky fakt i lartpërmendur, kujtesës që ende mbahej gjallë nga populli i Mbretit Gjergj Kastriotit, i cili kishte ushqyer një devocion të posaçëm për “Figurën e Zojës” dhe mureve, që ende mbaheshin që plotë 400 vjet me radhë nga populli si të shenjta, Carlo Pooten, kryepeshkvi i Shkodrës, në emër të ipeshkvijve të trevave shqiptare, më 22 shtator 1872, hodhi idenë para besimtarëve, që të jepnin kontributin tyre për rindërtimin e Shenjtërores së njohur “Zoja e Shkodrës”. Thirrja e bariut shpirtërorë pati një jehonë të madhe në popull dhe famulltarët e kishave të ndryshme. Më qindra njerëz iu përgjigjën thirrjes, në formë shtegtimi pendestarë e forma të tjera, për nevojat shpirtërore e tokësore, me një nderim tejet të gjallë dhe të zjarrtë. Gratë të çdo gjendjeje dhe të çdo moshe, madje edhe të klasës së lartë, shkonin me këmbë të zathura dhe përuleshin para atij vendi mbetur gërmadhë dhe duke bërë xhiro rreth mureve, largoheshin të përplotura me lutje të ngrohta.

Për ta promovuar edhe më tepër çështjen e Shenjtërores në popull, në vitin 1878, shënohet regjistrimi zyrtar i Shoqatës, (Kompania) “Zoja e Këshillit të Mirë”, e themeluar më parë që më 25 shkurt 1779, e cila merrej me organizimin e jetës shpirtërore, por dhe materiale. Në fillim funksiononte si Shoqatë brenda Kryedioqezës së Shkodrës dhe më pas edhe jashtë saj. Shoqata “Zoja e Këshillit të Mirë”, kishte krijuar degët e saj edhe jashtë Shqipërisë dhe gjatë viteve në vazhdim kishte ardhur duke u përforcuar gjithnjë.

Thirrja e Pooten, pos përkrahjes në fushën shpirtërore, pati mirëkuptim dhe në pjesën materiale për grumbullimin e ndihmave financiare, për ringritjen e Shenjtërores. Ndër letrat përkrahëse do veçonim: letra e një prifti nga Franca drejtuar arqipeshkvit të Shkodrës Imzot Pooten, me datë 10. 8. 1878, ku shpreh konsideratën për idenë e ringritjes së Shenjtërores së Zojës. Rilindësi, Pashko Vasa, në një letër më datë 27 tetor 1890, nga Beiruti, drejtuar Arqipeshkvit Guerini, ndër të tjera shkruan, se “*Tani duke sjellë në mendje se në rininë time*

unë isha një besnik i zjarrtë i “Zojës së Këshillit të Mirë” dhe se shpesh ndieja dëshirën për ta parë të restauruar atë Shenjtore, në mënyrë që në formën e një Kapele modeste, t’i mundësohej katolikëve edhe atyre që e ndjenin nevojën, që në mënyrë të përshtatshme të kremtonin Meshë dhe të ushtronin nderimin e tyre nën strehë brenda.” Ndërsa njëfarë Gjokë Banni, më datë 8 tetor 1895, përcjellë ndihmën për “Kishën e Zojës”, nëpërmjet famullitarit të Shkodrës, Agostin Barbullushit, e shumë letra të tjera të cilat arrinin gjatë viteve në vazhdim.

Pjesë e promovimit për Zojën si përmbajtje dhe për rëndësinë historike të Shenjtërores ishte dhe organizimi i Kolegjit Ksaverian në vitin 1890, në Shkodër, një akademi solemne me rastin e arritjes së një pikturë të “Zojës së Këshillit të Mirë”, nga Italia në këtë kolegji, dhuratë kjo nga bamirësi, Kolë Pali.

Për t’i dhënë një karakter edhe më zyrtar Shenjtërores, Arqipeshkvi i ri i Shkodrës, Pashko Guerini, me rastin e festës së “Zojës së Këshillit të Mirë”, më dt. 26 prill 1893, për së pari herë nga viti i largimit 1467, planifikonte organizimin e festës në rrënojat legjendare të Zojës, bri kalasë Rozafat. Por, guvernatori i Shkodrës, Bahri Pasha, duke kuptuar se kjo ngjarje përkujtimoreje në fakt është një nxitje e mëtejshme për ndërgjegjësimin e vetëdijes kombëtare shqiptare, ai nuk lejoi zhvillimin e kësaj ceremonie fetare në këto rrënoja, por duke u vetëkënaqur me përgjigjen, dha lejen që festa do mund të zhvillohej vetëm në katedralen e Shkodrës, gjë që edhe ndodhi. Për këtë arsye, kufizimet e ndryshme të popullit në këtë drejtim, shpeshherë bëheshin temë e diskutimeve të forta në mes arqipeshkvit Guerini e valisë së Shkodrës, kur ky i fundit kërkonte ndihmë për zgjidhjen e këtyre problemeve edhe nga vetë sulltani në Stamboll.

Kisha katolike duke qenë në të drejtën e saj historike, këmbëngulte për kthimin në identitet të këtij simboli të rëndësishëm kombëtar. Për t’i dhënë një hov të ri shpirtëror dhe kombëtar, ipeshkvijtë e dioqezave shqiptare në Koncilin e tretë të Arbrit, i cili u hap në Shkodër më 13 maj dhe përfundoi më 23 qershor 1895, në një letër më 27 qershor të vitit 1895, kërkuan nga Selia e Shenjtë që “Zoja e Këshillit të Mirë”, të shpallet zyrtarisht, Mbrojtësja e Popullit Shqiptar. Kërkuan njëherë që kjo festë të futet në liturgjinë zyrtare kishtarë, më 26 prill. Kjo kërkesë u pranua nga papati dhe më 25 shkurt 1896, papa Leoni XIII dha përgjigjen pozitive, duke ia kushtuar popullin shqiptar Nënës Qiellore, informon Imzot Guerini në letrën e tij, më 9 mars 1896. Ndonëse, Papa Leoni XIII, në vitin 1884, kishte miratuar lutjen zyrtare të përditshme (Oficien) e ri me Meshën e ditës dhe ditën e festës më 26 prill, le të shtojmë se në vitin 1903, Papa Leoni XIII, kishën e “Gjenacanos” do ta ngrrejë në rangun dhe dinjitetin e Bazilikave minore dhe më 22 prill të të njëjtit vit urdhëroi që në litanitë e Loretos të shënohet “Mater Buon Consilii” pas “Mater Admirabilis”.

Në kuadër të koncilin në fjalë, në një letër të mëparshme të Guerinit më 9 janar 1896, dërguar Propaganda Fides, në Romë, jepet arsyetimi i kërkesës për “Zojën e Këshillit të Mirë”, e ndër të tjera thuhet *“Në kreun e nëntë të pjesës së parë të Koncilin të tretë Provincial, ku u fol për nderimin ndaj Virgjërës së Lume, duke vënë në dukje se famullitë dhe Dioqezat Shqiptare kanë Pajtorët e tyre, por nuk është e njëjta gjë edhe për Provincën (Shqipërinë). Etërit e Koncilin për të rritur kultin dhe nderimin ndaj Virgjërëshës së Lume, duke iu lutur përkujdesjes suaj të madhe (Ati i Shenjtë), për një popull që ka nevojë për pishtar dhe hire, duke përcjellë edhe mendimin e klerit dhe të popullit, njëzëri kanë parë të arsyeshme që të gjejnë drejtim tek Ati i Shenjtë që Virgjërësha e Lume, e cila nderohet nën titullin e “(Zoja) e Këshillit të Mirë”, të shpallet Pajtorë e gjithë Shqipërisë dhe që në Shqipëri të ketë një kult të veçantë,”*... Po në të njëjtën letër, arqipeshkvi Guerini, shpjegon arsyen e mungesës së nënshkrimit të arqipeshkvit të Tivarit, Shimun Milinoviq, rreth kërkesës për shpalljen e Zojës Pajtorë të Shqipërisë *“Vetëm Imzot Arqipeshkvi i Tivarit, që ka nën juridiksionin e tij edhe disa famulli të Shqipërisë dhe ka të njëjtin Kalendar të Dioqezave shqiptare, për arsye të pozitës së tij në territorin e Principatës së Malit të Zi, deklaroi se nuk mund të pranonte planin e krerëve të tjerë siç figuron në letrën zyrtare, që në kopje jua përcjell, prandaj hiri që kërkohet është për Shqipërinë që gjendet nën*

sundimin turk, përjashto të gjithë territorin e Principatës së Malit të Zi". Prandaj, duket e natyrshme që përfaqësuesit e Kishës shqiptare dëshirojnë t'i kenë të njëjtat privilegje shpirtërore si ata të Shenjtërores në Gjenacano, ku figura e Zojës kishte emigruar në vitin 1467. Dokumentet e tjera të Koncilit flasin për angazhimin e krerëve të Kishës shqiptare dhe ballafaqimin e tyre me politikën shkatërruese të sundimit turk.

Në një letër të shkruar në gjuhën frënge, më 28 qershor 1995, etërit e koncilit i drejtoheshin Sulltan Abdyl-Hamitit II, me të cilën kërkohej mbrojtja e të drejtave të katolikëve në trevat e pushtuara shqiptare. Letra në fjalë në mënyrë të përmbledhur iu është dërguar edhe Prefektit të Propagandës Fide në Romë, Kardinalit Ledochovski, duke theksuar se akoma nuk kanë marrë përgjigje nga Stambolli për shqetësimet e shprehura në letrën e tyre. Ata kërkojnë ndërhyrjen e Shenjtërisë së tij, Papës Lonit XIII.

Aktet e koncilit të tretë, i cili ishte vazhdimësia e dy koncilëve të mëparshme, (1703 e 1871) u miratuan nga Kongregata Propaganda Fide në mbledhjen e përgjithshme dhe u botuan të plota në gjuhën latine në vitin 1897.

Mbajtja e koncilit të tretë të Arbrit i dha një shtytje të konsiderueshme shqiptarëve, për angazhimin e tyre të mëtejshëm në fushën shpirtërore dhe dëshirës së madhe për t'i ringritur sa më parë ato gërmadha bri kalasë Rozafati, në një Shenjtërore të denjë, siç ka qenë më parë në shek. e XV, kur afresku i Zojës qe larguar nga vendi ynë. Kjo gjë le të kuptohet nga dëshmitë e shumta të dokumentuara nga revista "Zoja e Shkodrës Drita e Shqypniis" e themeluar në vitin 1917, enkas për promovimin e historisë të kësaj Shenjtëroreje në aspektin fetar e kombëtar. Nga shënimet e kohës kuptojmë, se nderimi ndaj Zojës është zhvilluar si në kohën e salvimeve më të rrepta të Perandorisë Osmane edhe pse me kundërshtime të mëdha, po ashtu edhe gjatë luftës Ballkanike e Luftës së Parë Botërore.

Arqipeshkvia e Shkodrës si dhe Shoqata (Kompania) "Zoja e Këshillit të Mirë", kanë nxitur në tërë Shqipërinë, duke përfshirë edhe Kryedioqezën e Shkupit më seli në Prizren, që të kremtohet në çdo familje festa e "Zojës së Bekuar". Në vitin 1900 e 1908, janë organizuar në mënyrë zyrtare shtegtime të përmasave kombëtare, në Gjenacano, e shtegtime dhe lutje të kohë pas kohe, në Rrënojat e Shenjta, bri Rozafatit. Lutjet ndaj Zojës, shpreheshin besimtarët, i kanë ruajtur shqiptarët, me rastin e shpërthimit të depove ushtarake, të barutit në kala në vitin 1882; me rastin e tërmetit të fuqishëm kur ishte rrënuar së tepërmi pothuajse i gjithë qyteti në ditën e të "Shelbuemit", në prill të vitit 1905; e sidomos gjatë bombardimeve malazeze mbi rrënojat e "Kishës së Zojës" dhe Katedralen e Shkodrës, më 12-13 mars të vitit 1913. Thoshte populli, duke aluduar në Zojën e Shkodrës, "*Shkodra e ka orën çuat*".

Personi i cili pas vdekjes së Guerinit i dha një krah të fortë çështjes së përshtetërisë dhe rindërtimit të Shenjtërores, ka qenë kryepeshkvi i posa emëruar i Shkodrës, Imzot Jak Serreqi. Ai me ta marrë mandatin më 2 qershor 1910, shtoi evenimentet liturgjike ndaj Zojës së Shkodrës dhe kujdesin ndaj rrënojave që dergjeshin ditë për ditë.

Në një kohë kur akoma vazhdonin vuajtjet e shqiptarëve nga pushtuesit turq, Imzot Serreqi, më dt. 26 prill 1911, i kishte ftuar të gjitha famullitë e kryedioqezës për të bërë një përgatitje të mirë shpirtërore për gjatë nëntë ditëve para kremtimit zyrtar të Zojës së Shkodrës. Në ditën e festës, më 26 prill të vitit në fjalë, në Katedralen e Shkodrës, para një mase të madhe, u zhvillua një ceremoni e rrallë për kohën. Populli i bashkuar rreth barinjve të tyre, në shenjë pendese dhe nderimi ndaj "Zojës së Bekuar", pranuan në masë si ushqim shpirtërorë sakramentin e rrethimit dhe të kungimit, si dhe bekimet e shpërndara me të Shenjtërueshmin sakrament, (ostshensor) nga Imzot Serreqi. Me këtë rast, e përcjellë nga masa e popullit, ishte zhvilluar procesioni në formë proteste ndaj pushtuesve osman, nga kisha Katedrale me figurën e Zojës së Shkodrës për në gërmadhat e "Kishës së Zojës". Ceremoni të ngjashme shënohen të jenë zhvilluar edhe në vitet në vazhdim, sipas rrethanave politike në terren si dhe lutje të posaçme, përveç se në muajin prill edhe gjithë muajin maj, i quajtur si muaji i luleve. Pas largimit të pushtuesit turk të vitit 1912, ka filluar të kremtohej në mënyrë të organizuar nga

shkodranët festa “Zoja e Shkodrës”, si festë e qytetit të Shkodrës, e cila kremtohej, të hënën e tretë të muajit tetor. Mendohet se kjo festë në Shkodër daton që në shek. XVIII. Kjo festë është kremtuar edhe në vende të tjera e në veçanti në Gjenacano, ku si duket është dita përkujtimore kur është gjetur piktura e Zojës së Bekuar, e realizuar nga Shën Luka Ungjilltar, ku sipas kalendarit grek ishte më 18 tetor shek. X.

Nisja dhe përfundimi i Shenjtërores së “Zojës së Shkodrës”

Lufta Ballkanike, e cila e kishte si qëllim zgjerimin e shteteve fqinjë në dëm të shqiptarëve kishte shkaktuar trazira në gjirin e Kishës katolike. Imzot Serreqi, krahas angazhimit të tij për mbajtjen nën kontroll të situatës së ndezur politike, nuk e kishte lënë jashtë mendjes, synimin e tij, për të vazhduar nxitjen për angazhimin e gjithanshëm të përgatitjes për një fillim të ri e të mbarë, rreth ndërtimit të Shenjtërores së Zojës bri kalasë Rozafat. Serreqi, duke u treguar i vendosur për çuarjen përpara të gjithë këtë çështje, dhe shenjë falënderimi për ndihmën Hyjnore që ka dhënë Zoja e Bekuar për çlirimin vendit nga pushtimet turk në vitin 1912, dhe më pas më 12 maj të vitit 1913 me largimin e pushtuesve malazezë nga Shkodra, ai celebroi Meshën e Shenjtë në rrënojat e kishës së “Zojës së Shkodrës”, për së pari herë pas 446 viteve të largimit të figurës së Zojës nga ky vend. Ky ritual liturgjik si duket ishte bërë i zakonshëm në vitet në vazhdim edhe përkundrejt trazirave të reja të Luftës së Parë Botërore (1914-1918).

Rrethanat e reja politike të krijuara në Evropë e Ballkan, në gjithë këtë fatkeqësi shqiptare, për fat të mirë në Shqipëri më 10. 1. 1916, sollën praninë e Perandorisë Austro – Hungareze, aleatin tonë të ngushtë nga e kaluara jo fort e largët e pushtimeve osmane.

Imzot Serreqi, së bashku me ipeshkvijtë e dioqezave shqiptare, duke qenë vazhdimisht i idesë për ngritjen përsëri të këtyre gërmadhave, në këtë drejtim gjeti mirëkuptimin e duhur me qeverinë e Austro-Hungarisë, të përfaqësuar nga komandanti, Ingatio Trollmann, duke ndërmarrë nisjen e përbashkët për realizimin e kësaj veprë të rëndësishme fetare e kombëtare. Ishte viti 1917, vit jubilar, 450 vjetori i largimit të figurës murale nga “Kisha e Zojës”, e mbartur nga Gjergji dhe Sklavi, në vitin 1467 për në Xhenacano të Italisë. Me këtë rast, Imzot Serreqi, për festën jubilarë të 26 prillit të vitit 1917, së bashku me famullitarin e Shkodrës, dom Pjeter Gjuren, kishin përgatitur një program të ngjeshur festiv, i cili zhvillohej te muret e rrënojave të Zojës, që kishin mbijetuar në atë patalok që 450 vjet dhe kishën katedrale në qytetin e Shkodrës. Aktiviteti tek rrënojat kishte filluar më 23 prill, me ushtrime të ndryshme shpirtërore në popull gjatë tre ditëve, si: Litanitë, rruzarja, këngë të përshpirtshme, meshë e predikime festive të udhëhequr nga meshtarët e spikatur, si: P. Zef Geci, Komisar i Provincës Françeskane; Don Gasper Krasniqi, nga abacia e Oroshit; Atë Pashko Gjadri, i urdhrit jezuit; Don Ndre Zadeja, poeti i ëmbëlsirës, e shumë të tjerë. Procesioni në popull i nisur nga katedralja drejt rrënojave të Shenjtërores, kishte kulmuar me Meshën e Shenjtë solemne që u zhvillua në gërmadhat e vjetra të Zojës, e udhëhequr nga Jak Serreqi, në bashkë celebrim të Luigj Bumçit, ipeshkëv i Lezhës, i cili e kishte mbajtur predikimin e rastit, kryepeshkëv të Durrësit, Pren Bardhi, Gjergj Koletsi, i Sapës, e shumë meshtar. Nga ushtria mori pjesë komandanti i përgjithshëm, gjenerali Ingatio Trollmann, konsulli Krajl e sa të tjerë. Nga populli llogariten të kenë marrë pjesë rreth 7000 veta. Me këtë rast llogaritet të jetë mbledhur një lëmoshë financiare prej 1907. 20 koronash.

Kjo festë jubilarë ishte një fillim i një mobilizimi i të gjithëve në lidhje me projekt-idenë e paraqitur sa vite më parë nga hierarkia e lartë kishtarë në Shqipëri, për rindërtimin e një strehe me dinjitet për Zojën e Shkodrës. Ky vendim ishte marrë pasi ekzistonin argumentet bindëse nga tradita dhe faktet historike, siç janë shpalosur disa më lart, se aty pari, apo, po në ato rrënoja është vendi i shumë përfolur nga është shkëputur afresku i Zojës, që bëri një bujë të madhe në historinë tonë kombëtare.

Për këtë rast nga Imzot Serreqi, ishte formuar komiteti për koordinimin e punimeve dhe gjetjen e fondeve për ringritjen e Shenjtërores. Ky komitet kishte marrë përsipër dhe botimin e revistës “*Zoja e Shkodërs, Drita e Shqypniis*” si organ promovues i çështjeve në fjalë, për shënimin e mrekullive të ndodhura tek Shenjtëroreja dhe evidentimin e plotë të personave që jepnin ndihma financiare për realizimin punimeve. Në mesin e atyre që evidentoheshin, pos famullitarëve të kishave, spikasin emrat e ipeshkvijve në Shqipëri si dhe Imzot Lazër Mjeda, kryepshkëv i Shkupit, si shenjë përkrahjeje për këtë vepër me interes për kishën dhe kombin. Është interesant fakti se deri në fillim të punimeve shënohet se qyteti kishte mbledhur 83000 kurona prej kësaj shume 50000 qenë depozituar në Wienerbank, në Shkodër. Por, kërkesat për ndihma nga Imzot Serreqi, kanë qenë të vazhdueshme duke i dërguar famullitarëve të vendit qarkore, që të jenë aktiv në këtë sipërmarrje të madhe pune si dhe familje të pasura brenda dhe jashtë vendit.

Komiteti veprues, më 28 shkurt 1917, së bashku me komandantin Trollmann, duke dalë në terren kishte përcaktuar 130 metra hapësirë për së gjati nga terreni, dhe më 9 mars të këtij viti, kishin filluar rrafshimet duke krijuar për momentin dy pataloqe nga tri që ishin paraparë në projekt. Ndërsa në qershor të po këtij viti, duke thyer gurë e duke mbushur terrenin, kishte përfunduar rrafshimi i tre pataloqeve, që kapnin përafërsisht përmasat: 84 e gjatë më 50 metra e gjerë. Momentet e përgatitjeve kulmuan më 27 korrik 1917, kur komisioni i përbashkët në përbërje: Arqipeshkvia përfaqësohej nga famullitari Dom Pjeter Gjura, Komanda Austro-Hungareze nga inxhinieri Fux dhe Bizzaro, nga ana e parlamentit Eles Sokoli, prej financave Mikel Naraqi, e kadastrës Selim Efendi Alija, ato zyrtarisht dolën në terren dhe verifikuan çdo gjë për të cilën duhej të veprohej. Po në këtë ditë Korpus Komanda, ia dorëzoi komisionit tapinë për hapësirën e Shenjtërores, prej 10262 m², duke përfshirë një shtëpi buzë murit të rrugës dhe kazermën (kaushen), e cila ishte nga fundi i mureve të rrënuara. E gjithë hapësira e dhuruar Arqipeshkvisë ishte vlerësuar me një shumë prej 75.000 koronash. Në shenjë falënderimi për gjithë këtë dhuratë, më 31 korrik në ditën e Shën Ignjac Lojolës, që ishte dita e emrit të gjeneralit Trollmann, u celebrua një meshë e shenjtë nga dom Ndre Plani. Pas meshe u hodh një shenjë konkrete e simbolike për atë çfarë do të ndodhte më vonë, duke bekuar gurin e portës së rrethimit të Shenjtërores nga famullitari i Shkodrës, Dom Pjeter Gjura. Pas këtij veprimi, mbeturinat turke organizuan një grup individësh mysliman shqiptar, që zhvilluan një protestë para Ministrisë së Luftës në Vjenë, duke pretenduar së aty në shek. XVII, kanë qenë rrënojat e një Teqeje bektashiane. Por, meqenëse nuk kishte baza ligjore kërkesa nuk u përfill aspak dhe puna vazhdoi sipas ritmit të paracaktuar.

Pas përgatitjes së mjaftueshme të punës ndërtimore: sheshimit të terrenit, ndërtimit të murit rrethues, analizës së mureve ekzistuese, e idesë së qartë për rindërtimin e ndërtesës, e cila cilësohej si kryevepër në vendin tonë, më 17 gusht 1917, populli i të gjitha moshave, i ardhur nga qyteti e rrethinat, duke u grumbulluar tek rrënojat, morën pjesë në bekimin e gurë themelit të parë për ringritjen e “Kishës së Zojës” bri kalasë Rozafat. Ceremoninë e bekimit e udhëhoqi Imzot Serreqi, i shoqëruar nga ipeshkvijtë e vendit dhe kleri i gjitha famullive. Meqenëse atë ditë nuk qe i pranishëm gjenerali Trollman, për shkak të obligimeve në Vjenë, nënshkrimi i pergamenës me shënimet përkatëse, qe zhvilluar më 8 shtator të këtij viti, ditën e të Lindurit të Zojës, në praninë e gjeneralit dhe baroneshës Marie Trollmann, oficerëve të gardës dhe hierarkisë së lartë kishtare. Më 17 tetor 1917, në praninë e famullitarit të Shkodrës u vendos gur themeli i absidës qendrore nga inxhinieri Fucks, si shenjë orientimi për riparimin e ndërtimin edhe të dy absidave të tjera me dimensione më të vogla që do të kryheshin.

Planimetria e kishës, e projektuar nga austriakët, në pjesën më të madhe ishte mbështetur në muret e rrënuara ekzistuese. Muret dalloheshin shumë qartë në përmasat e tyre edhe pse të dëmtuara nga dhëmbi i kohës. Muret në disa momente shkonin deri në dy metra e më tepër, duke përfshirë këtu edhe harqet e dyerve e dritareve, që spikasin të plagosura si dhe

pjesët e tri absidave (gungat) e tri dhomave, ku e mesmja dallohej nga madhësia më e madhe nga të dy dhomat, me dimension të njëjtë në të dy krahët e Kishës qendrore.

Sipas shënimeve të kohës, objekti i Kishës në kohën e fillimit të rindërtimit, në vitin 1917, pati këto përmasa: 30 e gjatë me 20 e gjerë. Mjedisi i kishës ishte paraparë të jetë 10 metra e lartë, kurse krahët e kishës 7 metra të larta. Në anë të altarit kryesorë ishte paraparë të jetë kambanorja. Ndërsa, në anë të absidës (gungës) në të djathtë, ishte përpara dhoma për sakristij (dhoma për rrobat e meshës) dhe në tjetrën anë dhoma e përgatitjes së meshtarëve, të dyja me dimensione të njëjta, në krahasim me pjesën qendrore, e cila ishte me dimensione më të mëdha. Nga fotot e vitit 1923, kuptohet, se sa ka qenë lartësia e murit të vjetër në pjesët anësore dhe ato ballore si dhe dalja jashtë në pjesën qendrore të Kishës. Nga përshkrimet e paraqitura kuptohet se objekti i ri i filluar në vitin 1917, ka qenë mjaft mirë i përshtatur me planimetrinë e vjetër të ndërtimit, i cili mendohet se ishte po ai ndërtim i parë i shek. XIII.

Kemi një statistikë kureshtare rreth punimeve. Në muajin gusht të vitit 1918, punimet i zhvillonin: 11 punëtorë muri, 5 punëtorë që thyenin gurë, e 13 punëtorë krahu. Punimet kishin arritur deri në këtë fazë: Muri i absidës qendrore ishte ngritur më tepër se katër metra dhe muret e dhomës për sakristi kishin mbaruar, si dhe pjesa veriore e mureve të kishës ishin ngritur dy metra mbi muret të vjetra. Në këtë pjesë qenë vendosur harqet e tri dritareve dhe derës, si dhe harku i altarit qendrore. Në këtë përshkrim del dhe fakti se harqet si dhe kolonat e kishës kanë qenë duke u punuar nga gurët e gdhendur.

Në vitet në vazhdim, shënohet një ngecje e punimeve në Shenjtëroren e Zojës. Nga revista “*Zoja e Shkodërs*” e muajit maj të vitit 1919, kuptojmë se ka probleme financash dhe nga ana tjetër, një faktor tjetër del edhe situata e keqe politike në vend, pas largimit të Perandorisë Austro-Hungareze, më 30. 10. 1918, nga Shqipëria. Po kështu revista “*Zoja e Shkodërs*,” e cila ishte promotore kryesore e Shenjtërores edhe pse nuk jepte shenja mbylljeje, ajo në fakt pas muajit qershor-korrik 1919, nuk doli më. Nga ana tjetër, kuptojmë së Imzot Serreqi edhe pse ishte në një moshë të pjekur, për shkak të problemeve serioze shëndetësore kardiale në vitin 1921 kishte dhënë dorëheqjen dhe vdiq në prill të vitit 1922, duke u varrosur sipas porosisë së tij në “Kishën e Zojës” së papërfunduar.

Ardhja e kryepeshkvit të ri të Imzot Lazër Mjedës, në vitin 1922, në Shkodër, solli impulse të reja pozitive rreth organizimit të punimeve. Ai, me një qarkore të datës 29. 09. 1923, drejtuar klerit dhe bamirësve, duke pranuar gjendjen e vështirë ekonomike në popull dhe mungesën e fondeve për vazhdimin e punimeve, apelon që të merren forca të reja për t’i dhënë një shtytje rishtas punimeve në Shenjtëroren e Zojës.

Lazer Mjeda, duke apeluar për ndihma nga jashtë vendit, në vitin 1924, merr përgjigje pozitive nga disa persona nga Bari i Italisë si dhe nga pronari i hotel “*Internacionale*” nga Bari për xhamat me ngjyra dhe për dritaret e “Kishës së Zojës” bri kalasë Rozafat. Mjeda në vitin 1928, shfrytëzon rastin që të njoftojë edhe kardinalin, Vincenzo Vannulli, për vlerën shpirtërore dhe historike që ka për shqiptarët, për punimet e fundit që janë duke u bërë në Shenjtërore dhe në lidhje me mungesën e fondeve që t’i përfundojë ato.

Pasi punimet e përgjithshme ishin para përfundimit, pritej sistemi i punimeve me gurë graniti nga brenda, duke përfshirë edhe pajisjet me mobiliat përkatëse. Për pajisje Mjeda, iu drejtua Shenjtores së Zojës në Gjenacano, Itali për ta ndihmuar në këtë drejtim. Nga Shenjtërorja homologe e Gjenacanos, kishte marrë premtime për pajisje në orendi, rroba për mëshim si dhe në letrën më 18 tetor 1928, premtohet një riprodhim origjinal i afreskut për ta vendosur në kishën e posa rindërtuar. Në anën tjetër, nga korrespondenca e Imzot Lazër Mjedës, me prefektin e qarkut dt. 10. 2. 1930, mësojmë së materiali dekorativ i ardhur nga Italia për finalizimin e punimeve të brendshme të Kishës, ishte bllokuar në portën e Durrësit, për shkak të procedurave doganore. Mjeda me këtë rast nga qeveria kërkonte që ky mall të lirohet nga pagesat doganore. Me këtë rast, nga letra përcjellëse e Mjedës për doganën e Durrësit, pa shënim date, dalin shënime interesante nga mund të kuptojmë sesa dhe çfarë materiali

dekorativ është përdorur për punime në Kishën e Zojës së Këshilli të Mirë. Për shembull: 429 copa xhama pikturuese, gur graniti i quajtur “Korcolle” nga Roma, për 200 metra këmbë shkallë dhe rrasa me lustër për shkalla përkatëse, 2 altarë graniti dhe këmbë shkalle, shtylla e trenca dhe rrasa dysHEMEJE përreth altarit. I gjithë materiali i granitit “Korcolle” kishte një peshë të përgjithshme prej 31 900 kg.

Së fundi, pas shumë viteve punimesh të ngadalësuara, çdo gjë ishte gati për inaugurimin e këtij objekti gjigant, me vlera të mëdha fetare, historike e arkitekturore. Dita e inaugurimit sipas një burimi do ishte ditën e “Zojës së Këshillit të Mirë”, apo “Zojës së Shkodrës”, pajtorës së Shqipërisë, më 26 prilli 1930, por, sipas Gjush Sheldis, dhe një fotografie të Marubit mund të këtë qenë më 26 prill 1931. Ishte një ditë e pritur prej kohësh nga shumë breza të cilët kishin ëndërruar që ta shohin të realizuar Shenjtëroren me gjithë atë shkëlqim që e kishte pasur që kur ishte ndërtuar në shek. XIII.

Në muajin pasues, më 18 maj 1930, në Shkodër pati ardhur një komision nga Gjenacano, duke sjellë një kopje të origjinalit të “Zojës së Shkodrës”, dhuratë kjo e çmuar, e cila që vendosur në kishën e re të posa rindërtua. Kjo ngjarje solemne do të hyjë me siguri në histori, duke vulosur përforcimin e traditës disa shekulle të shtegtimit të mrekullueshëm nga Shkodra në Gjenazano dhe duke hapur shtigje të reja për të ardhmen në mes dy palëve. Si rezultat frytdhënës ishte organizimi masiv i shtegtimit nga Shkodra për në Gjenacano në vitin 1932, nga Imzot Lazer Mjeda, ngjarje kjo që bëri të përforcoheshin lidhjet vëllazërore fetare dhe miqësinë mes shkodranëve dhe Gjenacanezëve.

“Kisha e Zojës” - sprovat e reja dhe Viti Jubilar

Nderimi dhe përshpirtmëria ndaj “Zojës së Shkodrës” ka vazhduar të jetë aktuale edhe në vitet në vazhdim. Ditën e festës së Zojës, më 26 prill, janë organizuar procesione të vazhdueshme nga viti 1930 deri në vitin 1947, duke u nisur nga Katedralja deri të Shenjtërorja e Zojës. Më përforcimin e sistemit komunist e ateistë e kur Kisha katolike ishte vendosur nën vëzhgime të rrepta sigurie, procesionet në këtë relacion ishin ndërprerë. Me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së dogmës, së Zojës së Papërljeme, kremtuar më 8 dhjetor të vitit 1954, nga Imzot Ernest Çoba, ishte organizuar procesioni me figurën e “Zojës së Shkodrës”, jo si më parë, por rreth Katedrales i cili qe i fundit i këtij llojit.

Sistemi komunist ateist në vitin 1967 duke mbyllur e rrënuar objektet fetare, nëpërmjet Komitetit ekzekutiv më datë 16. 7. 1966, kishte miratuar vendimin ushtarak që “Kisha e Zojës”, të shpallet zonë e ndaluar. Me këtë vendim Petro Papi, kishte njoftuar edhe Imzot Ernesto Çobën, kur ky i fundit kishte protestuar ashpër ndaj vendimit të dhënë më parë, duke dërguar një telegram proteste me datë 1 qershor 1966, drejtuar Enver Hoxhës për uzurpimin e Kishës. Së fundi, Kisha gjigante e ndërtuar me shumë mund e djersë dhe me aq lavdi historike, sipas Hamdi Bushatit në vitin 1968, u ngrit në erë nga inxhinierët ushtarak, duke ndërtuar aty një lapidarë, në nder të partisë. Por, krahas kontrollit të dokumenteve në Arkivin e shtetit dhe Arkivin e Ministrisë së Mbrojtës, nuk u gjete viti i saktë i shkatërrimit. Ka gjasa se dokumentet e kësaj natyre mund të jenë asgjësuar.

Edhe pse objekti nuk shfaqej më në sytë e njerëzve si bukuri ndërtimore, imazhi i Zojës, kishte mbetur i ngulitur thellë në mendjen e zemrën e mijëra besimtarëve nga të gjitha trevat shqiptare, por ai kishte shpërthyer me ardhjen e demokracisë. Por, sa paradoksale! Më parë objektet fetare e kulturore na i shkatërronin të tjerët, tani i shkatërronim ne vetë.

Pas demokratizimit të vendit në vitin 1991, populli i etur për besim nga misteret Hyjnore, përsëri iu kthye devocionit ndaj Zojës, aq më tepër, kur Papa Gjon Pali II, gjatë vizitës së tij historike në Shqipëri, më 25 prill 1993, bekoj gurëthemelin për rindërtimin e dytë të kësaj shenjtëroreje. Pas punës së ngadaltë disa vjeçare dhe cilësisë shumë të dobët, ku muret qenë punuar me blloqe betoni, objekti i ri i realizuar me pak ndryshime në krahasim me planimetrinë

e mëparshme, u inaugurua më 24 maj 1998, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Selisë së Shenjtë, Kardinalit Jozef Tomko, ipeshkvijve nga të gjitha trevat shqiptare dhe arbëreshëve të Zarës, përfaqësuar nga ipeshkvi Ivan Prengja dhe donatori kryesor, don Simeone Duka. Fjalën përshëndetëse për mysafirët e lartë kishtar dhe shtetërorë e mbajti, kryepeshkvi i porsa emëruar i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra.

Meqenëse historia e gjithë kësaj Shenjtëroreje lidhet ngushtë me afreskun e “Zojës së Këshillit të Mirë”, i shkëputur nga muret e saj në vitin 1467 dhe të dërguar për në Gjenacano, në vitin 2017, përkonte me 550 vjetorin e kësaj ngjarje të rëndësishme historike për popullin tonë.

Nisur nga ky fakt, famullitari i Shkodrës, dom Artur Jaku, së bashku me Dom Nikë Ukgjinin, në siglën e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, arritën për të realizuar në Shkodër një program përmbajtjesorë për këtë vit jubilar të madh e të rrallë. Me këtë rast pas realizimit të programeve shpirtërore, më 22 prill u realizua Konferenca Ndërkombëtare me temën: “*Zoja e Shkodërs, Drita e Shqypniis*”, ku morën pjesë studiues nga Italia dhe vendi ynë. Gjithashtu me angazhimin e famullitarit të Shkodrës dhe me ndihmën e Ministrisë së Kulturës, u restaurua në Firence të Italisë piktura legjendare e Zojës së Shkodrës e vitit 1898, e cila u përrua më 25 prill të këtij viti, po në Shkodër.

Të shtyrë nga kureshtja për të mësuar diçka më shumë për këtë afreske magjike, si paraprijë e konferencës shkencore të cituar më lart, më 19-21 mars të këtij viti, realizuam një ekspeditë shkencore ndërkombëtare, në Gjenacano të Italisë, për ta analizuar nga afër me mjete moderne imazhin e “Zojës së Këshillit të Mirë”, që ndodhet e vendosur në pjesën veriore të bazilikës, i siguruar dhe i zbukuruar me një kasë dhe korniza ari. Studiuesit e artit dhe specialistë të restaurimit, si dhe të fizikës bërthamore, shqiptar dhe italian, pas analizave të bëra, ndër të tjera kanë konstatuar se “*Ikona në fakt përbëhet nga një pjesë pikturë murale me dimensione 77.5 - 42.5 cm, e jo 42.5- 37 cm, siç jemi mësuar ta shohim deri tani. Piktura është lidhur me murin ekzistues dhe gati gjysma e pjesës së poshtme e pa ekspozuar mungon. Ikona është rrethuar me një altar të zbukuruar dhe mbrohet nga një fletë qelqi e trashë. Përdorimi i pigmenteve minerale si më lart të bën të mendosh se teknika e pikturimit duhet të jetë afresk*”. Studiuesit janë të mendimit se dëmtimi i pjesës së figurës, e cila sot ende është e pa ekspozuar, mund të ketë ndodhur gjatë shkëputjes nga muri i kishës, bri kalasë së Shkodrës dhe vendosjes në muret e kishës në Genazzano.

Kjo analizë shkencore e bëri të qartë se dëmtimi në pjesën e poshtme është arsyeja pse imazhi me shekuj është paraqitur nga papët e studiuesit evropian me dimensione 42.5 x 31 cm, apo sipas piktorit të njohur nga Gjenova, Luigi Tossin në vitin 1747, në analizën e tij ku flet se figura “*asht dy pllamë e giatë e një e gjysë e gianë*”. Paraqitja e imazhit në formën e reduktuar vazhdon të ekspozohet dhe pikturohet edhe sot po në këtë mënyrë. Dhe në bazë të analizave kimike, gjeologjike etj., mendohet së afresku do jetë punuar në zonat rajonale kufitare. Edhe studiuesja, Fatbardha Shkupi, më parë ka konstatuar se “*Kisha e Zojës*” nën kala, është e stilit gotik e shek. XIII, kurse afresku i “*Zojës së Këshillit të Mirë*” është si ajo e “*Kishës së Shirqit*”. Në bazë të gjitha argumenteve të cituara më lart, del se Shenjtërorja dhe imazhi i afreskut janë prodhim i mendjes dhe zemrës të popullit shqiptarë të Shkodrës së shek. XIII.

Dom Nikë Ukgjini

The Sanctuary “Our Lady of Shkodra” in relation to historical commitments (15th-20th centuries)

Summary

The awakening of devotion to the Blessed Virgin in the early Middle Ages in Europe has also reflected on the Albanians, who have also expressed this worship in works of art. All this is understood by the numerous constructions of religious and cultural objects that took place in the Archdiocese of Bar, the diocese of Ulcinj, Shkodra, Drishti etc, which were dedicated to Our Lady, or Our Lady of Good Counsel. One of them was the Church of “The Annunciation of Our Lady”, the royal fortress Rozafat in Shkodra built in the 13th century. This Church, which had received the epitaph of the Sanctuary because of the valuable fresco of Our Lady, and the environment where it was realized, had a very interesting and sensational story. During the second siege of Shkodra by the Turks, the two Church guards, in order to save the destruction of this work of art, cut it off from the walls in 1467, and the figure took place in the Agustinian Assembly in Genazzano near Rome.

Honoring Our Lady, presented through this figure in Gennazano, won, through the papacy, the popularity of the world. The popularity was increased even by the book of Mons. George F. Dillon “The Virgin Mother of Good Counsel”, Rome, 1884 and in Italian, Mons. Giorgio F. DILLON, *La Vergine Madre del Buon Consiglio in Genazzano. Da Scutari in Albania a Genazzano*, (translated from English by Giuseppe Pifferi), Siena, 1892.

The Albanians of the diaspora in Italy were part of the honor of this figure, who managed to raise awareness of Albanians in Arbëria. Even though it was still under the Turkish crag, with the help of the Italian experts, the Church in Arbëri succeeded in proving that the ruins of the Church of Our Lady at the foot of Shkodra fortress are the same ones when this figure left in the 15th century from our country. The local church at the 3rd Council of Arbër in 1896 proclaimed the “Our Lady of Good Counsel” patron of Arbëria and in 1930 inaugurated the reconstructed Church in the old ruins where the fresco of Our Lady had previously been taken away.

During the time of the atheist communist dictatorship, this church was demolished in 1968, to be rebuilt again after the country's democratization in 1998.

The Year 2017 coincided with the 550th anniversary of the flee of this figure, so on this occasion several activities were organized; among them was the sending of experts and scholars, Albanian and Italian restaurateurs, on April 19-21 of this year, for a detailed analysis of the image of Our Lady in Genazzano. After the analyzes, among other things, they concluded that: “The icon is actually a piece of wall paintings of dimensions 77.5*42.5 cm rather than 42.5*37 cm as we have been accustomed to seeing exposed so far. And based on chemical, geological, analysis, etc., it is thought that the fresco has been worked on the regional border areas. Even the scholar Fatbardha Shkupi has previously stated that the Church of Our Lady under the castle is of the Gothic style of the 13th century, while the fresco of Our Lady of Good Counsel as that of the Church of Shirq. Based on all the arguments cited above, it appears that the sanctuary and the image of the mural are the product of the mind and heart of the Albanian people of Shkodra from the 13th century.